



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal të mbajtur me dt.29.08.2025, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Florije Jashari (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi, (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala, (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Valon Svirca (LVV), Albana Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Linda Sadiku Krasniqi, (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL)

Të pranishmit tjerë: drejtorët komunal, përf. e OSBE-së dhe përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit Komunal për periudhën Janar-Qershor 2025
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës nga Drejtoria për ekonomi, financa dhe zhvillim për transfer të mjeteve
5. Plani i veprimeve për Zbatimin e Rekomandimeve për Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2024
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës nga Njësia e Burimeve Njerëzore për Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Obiliqit
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës nga Njësia për Mbrotjtje nga Diskriminimi për dhënien në debat publik të Planit për të drejtat e fëmijëve 2026-2029
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 18 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Mungoi: Lendita Krasniqi dhe Biljana Spasic

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 18 vota për.

Pika 3 e rendit te dites

Kryesuesja – Paraqiti Raportin e punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit Komunal për periudhën Janar-Qershor 2025.

Enver Gashi – Ne si grup edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa kemi dhëne vizën që ky raport është i mirë, është me kohë nuk kemi ndonjë vërejtje.

Sami Ahmeti - Me thënë të drejtën nuk është që ka ndonjë gjë që na dëshmon në formë krahasimore rritje të mirëqenies apo ndonjë gjë tjetër nga viti i kaluar edhe ky raport është në vazhden e raporteve të mos punës, konsideroj unë. Një e mirë është që ky raport është raporti i fundit që ky Kryetar dhe ky Ekzekutiv na e dërgon neve.

Enver Gashi - I nderuar anëtar i Kuvendit, ke të drejtë të diskutosh për raport por jo të gjykosh është raporti i fundit apo jo, atë e jepë verdiktin sovrani dhe jo ju. Ne jemi mat tri herë ku keni qenë edhe ju, dhe do të matemi edhe tri herë e katër aq sa keni ju fuqi me na ndjekë e me na pa, e për zhvillim krejt sovrani e shehë i shijon e i prek edhe i vlerëson.

Sami Ahmeti - Unë e them atë që e mendoj dhe nuk ka nevojë askush me më tregu mu çka me thënë. Unë ty te kisha thënë decedivisht z.Enver Gashi, të lus shumë mos shko në zyret e Ministrisë të Punëve të Brendshme në ARC edhe me i pyet njerëzit edhe me i kushtëzue për votë sepse ka raport për ty në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Enver Gashi - A ka raport apo nuk ka, a i kam thënë dikujt a e kam kushtëzuar, ato punë i udhëheqë dikush tjetër jo unë. Unë nuk e kam për herë të parë këtë por për herë të katërt, ose për herën e gjashtë që marrë pjesë në zgjedhje e nuk e kam asnjë vërejtje. Nëse, ke diçka është krejtë në rregullë, mirëpo nëse është e pabazë ligjet i sanksionojnë edhe ata edhe ata.

Kryesuesja - Ju kisha lutë që ti përmbaheni rendit të ditës, raporti sic e dijmë nuk votohet.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nga Drejtoria për ekonomi, financa dhe zhvillim për transfer të mjeteve.

Enver Gashi - Ne si grup jemi që kjo kërkesë e Drejtorisë për ekonomi, financa dhe zhvillim për transfer të mjeteve të aprovohet.

Sami Ahmet - Kategoria mallra dhe shërbime, në gjendje normale është e parashikueshme dhe nuk po me duket normale që mjetet e parapara për subvencione në kulturë ku ka mundësi të shumta të subvencionohen të bartën në një sektor tjetër. Njëjtë edhe te arsimit jemi në një gjendje të njëjtë një shumë e madhe e të hollave kalon tek kategoria mallra dhe shërbime, ashtu sic e thashë në fillim është lehtë e parashikueshme. Do të thotë këta dy sektorë kanë nevoja të shumta dhe ti merren edhe ato pak mjete që i kanë të dërgohen diku tjetër, ku për informacion për ata që se dijnë kategoria mallra dhe shërbime përfshin kryesisht gjëra që parashikohen shumë lehtë, është fjala për materiale administrativ higjienike, shëndetësore por edhe derivate e mbushje të telefonave që siç e dijmë në këtë fazë ju duhen shumë.

Zarife Behluli - Kërkesa ka baza që ne kemi kërkuar të bëjmë transferin e mjeteve pasi që thesari i Kosovës na ka marrë mjetet në mallra dhe shërbime dhe këto mjete kemi pasur mundësi të bëjmë transfer në mallra shërbime, që ti mbulojmë disa shpenzime tjera. Mendoj se as nuk ka favore as nuk ka dëshira as kurrëgjë, por ka obligime të pakryera dhe kur e kam bërë kërkesën edhe 334 euro nga ndërtimi i kanalizimit që është mbyllë kontrata që kanë mbetë kam shkruar poshtë sqarim që të kalojnë tek vija e kogjenerimit, për njoftim të anëtarëve të Kuvendit. Është vlerë e vogël por ti shfrytëzojmë që të mos i lëmë të pashpenzuara në fund të vitit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 11 vota për, 6 kundër dhe 2 abstenim e aprovuan Vendimin për transfer dhe rialokim të mjeteve për vitin 2025.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti planin e veprimeve për Zbatimin e Rekomandimeve për Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2024.

Enver Gashi - Edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, e kemi trajtuar këtë temë, janë të metat e qeverisjes ato çka janë gjetur nga auditori, aq sa kam informata një pjesë janë eliminuar dhe tjerat në proces janë kështu që që nga fundi i shtatorit duhet të përfundohen të gjitha.

Sami Ahmeti – Këtu, te kolona po shkruan rekomandimi 2023, në raportin që ju na keni dërguar ndërsa sa i përket sa janë kryer si procese nuk më duken se janë kryer, janë shumë të parapara në vitin 2026 që ne e mirëpresim këtë fakt. Ndërsa, ne nuk e dimë se si flasim për përmirësim të gabimeve që qëllimisht janë bërë, shpresoj që të jetë ashtu.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nga Njësia e Burimeve Njerëzore për Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Obiliqit.

Enver Gashi - Kjo Rregullore ka qenë në debat publik, është përfunduar sa i përket anës ligjore, pastaj ka ardhë tash edhe në Komitet dhe e kemi dhënë vizën që të vijë edhe në Kuvend sot. Ne si grup edhe pse kemi rekomanduar për një plotësim të sekretarisë së Kuvendit nuk e kanë plotësuar, konkretisht një jurist andaj e votojmë këtë Rregullore por me një plotësim të një anëtari të Sekretarisë së Kuvendit Komunal.

Sami Ahmeti - Kryesuese në lidhje me këtë Rregullore është e vërtetë që në Mars të këtij viti ky grup punues ka kërkuar komente nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, të cilat komente i kanë pranuar disa prej tyre dhe i kanë inkorporuar në këtë Rregullore. Po ashtu, në seancën e muajit Maj për këtë Rregullore kemi proceduar në debat publik, madje ju kemi lutë që mundësisht të na informoni, gjë që nuk kemi marrë ndonjë kërkesë. Tani, kjo Rregullore shohë se ka disa defekte se ju thashë edhe në mbledhje për Komitetin për Politikë dhe Financa, që do të provoj pa politikë sepse kemi parasysh që kjo Rregullore i përfshin një numër shumë të madh të zyrtarëve të Komunës së Obiliqit, dhe do të doja që ata të trajtohen njësoj dhe mirë. Unë shohë që ka disa defekte që tash nuk mund të trajtohen dhe rrjedhimisht do të na kthehet në Kuvendin Komunal. Disa vërejtjeve janë tek Njësia e Auditimit, e cila nuk mund të funksionoj si Njësi me dy zyrtar, duhet të jenë të paktën dy zyrtar dhe një udhëheqës ndërsa, në Rregullore i kanë vendos vetëm një zyrtar dhe një udhëheqës. Kjo, do të thotë udhëheqësi është shef i një punëtori, disa pozita i keni me tituj te njëjtë por kategori të ndryshme, psh Zyrtar i Lartë për Ndërtimtari në Urbanizëm është profesional I (një) kush e kupton çka do të thotë kjo, ndërsa Zyrtar i Lartë për Ndërtimtari në Infrastrukturë, titulli i njëjtë është specialist, kriteret e shkollimit ose grupet ku merren tek Rregullorja e Klasifikimit janë të njëjtat. Po ashtu, dallimi në pagë është 140 (një qind e katërdhjetë) euro dmth është gabim dhe do të iu kthehet prej Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve. Pastaj, kemi pasur komente tek Sektori për Mirëqenie Sociale të cilat nuk janë inkorporuar në Rregullore, kur ju keni marrë komente nga DMZP-ja, është kërkuar që para se të procedohej me miratimin ose finalizimin e kësaj Rregulloreje të merrni konfirmimin përfundimtar sepse kështu po e bëjnë të gjitha Komunitat. Kjo Rregullore është një Rregullore shumë e rëndësishme që ndërlidhet nga Ligji për Zyrtarë Publik dhe Ligji për Paga dhe do të thotë nuk është marrë një gjë e tillë, të kuptohemi. Ne jemi që kjo Rregullore të miratohet dhe të bëhet sa më e përshtatshme për zyrtarë, mirëpo si e tillë unë kam konfirmim edhe nga DMZP-ja që do të kthehet në rishqyrtim, unë ju kisha lutë që paraprakisht të bëhen këto përmisime e pastaj me miratue në seancën e ardhshme sepse si e tillë do të zvarritet në tri, katër seanca derisa të bëhet. Ndërsa nëse shkon tani si është dashtë të shkoj kjo Rregullore do të miratohej sot dhe nuk do të kishim asnjë koment negativ nga DMZP-ja.

Antigona Morina - (Udhëheqëse e Njesisë së Burimeve Njerëzore) - Ne kemi paraqitur para juve Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me qëllim të shqyrtimit dhe miratimit me qëllim që të kemi një strukturë organizative në Administratën Komunale. Siç e dini dhe ju e kemi Ligjin e Zyrtarëve Publik, Ligjin e Pagave, Rregulloren për Klasifikimin e Vendeve të Punës si dhe Katalogun e Vendeve të Punës, të cilat na kanë obliguar domosdo të kemi një Rregullore për Organizimin e Brendshëm. Grupi punues ka punuar duke u mbështetur në Legjislacionin në fuqi dhe Rregulloren e kemi dërguar për mendim juridik në DMZP, pastaj kemi marrë edhe disa rekomandime. Të gjitha rekomandimet i kemi paraqitur në këtë Rregullore dhe jemi munduar ti paraqesim të gjitha pozitat dhe hierarkinë në Institucionin Komunal. Në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale nuk kemi ndonjë mendim tjetër përpos këtyre që i kemi paraqitur, kështu që mendoj se Rregulloren duhet ta aprovojme përndryshe nuk do të mund të funksionojmë ndryshe. Sa i përket ndryshimeve që i paraqiti anëtari i Lëvizjes Vetëvendosje, të gjitha pozitat i kemi marrë nga katalogu i vendeve të punës, disa pozita janë

specialistë, disa janë zyrtarë të lartë, disa pozita janë zyrtar të ndërtimit, varësisht prej punës. Ndërsa, sa i përket propozimit të anëtarit të LDK-së, për momentin nuk kemi mundësi sepse numri i stafit është i kufizuar nuk mund të ketë sektor pa mbikëqyrës, ose mbikëqyrës pa punëtor sic e tha edhe anëtari i Kuvendit. Një udhëheqës duhet ti ketë 2 ose më shumë zyrtarë, për momentin nuk i kemi mundësitë, as numrin e punëtorëve, e as buxhetin. Mirëpo, në të ardhmen do ta shohim si mundësi shpresoj që do të realizohet.

Sami Ahmeti - Pa dashtë me repilikuar ato që i thashë janë edhe konfirmime të zyrtarëve të DMZP-së, dhe nuk i thashë prej vetes, por është DMZP-ja që unë e kam dërguar këtë Rregullore dhe mi ka kthyer vetëm disa prej tyre sepse ka shpërputhje të mëdha edhe me katalogun edhe me të gjitha tjerat. Të kuptohemi, unë nuk kam asgjë kundër që të bëhet një Rregullore e mirë por si e tillë mue më është konfirmuar që do të kthehet prapë, kështu që ne do të abstenojmë në këtë Rregullore dhe sigurisht që dikush do të ketë mundësinë prej këtij Kuvendi, ta votoj por do të rishikohet në seancat e ardhshme.

Enver Gashi - Ne duhet te pajtohemi me udhëheqësen e Burimeve Njerëzore sepse e njëjta po thirret në ligj dhe Rregullore. Atëherë, e votojmë si të tillë, ndërsa sa i përket asaj se a kthehet në rishqyrtim apo jo nuk është në menaxhimin tonë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me me 11 vota për dhe 7 vota abstenim morën Vendim për aprovimin e Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Obiliqit.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti Shqyrtimi dhe aprovimin e kërkesës nga Njësia për Mbrojtje nga Diskriminimi për dhënien në debat publik të Planit për të drejtat e fëmijëve 2026-2029.

Enver Gashi - Edhe ne Komitetin për Politikë dhe Financa e kemi dhënë vizën që kjo kërkesë të dalë në debat publik edhe kur kthehet në Kuvend ne e japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti - Ne jemi dakord që ky dokument të dalë në debat publik.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 18 vota për morën Vendim për dhënien në debat publik të Planit për të drejtat e fëmijëve 2026-2029.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga MMPHI-ja, për shfuqizim të vendimit të dt.29.07.2025, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Plemetin.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 14 vota për morën Vendim për Shfuqizimin e vendimit nr.01-060-01-21401-25, të dt.01.08.2025 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Plemetin.

Pika 9 e rendit të ditës

Labinot Mirena - Unë e kam një kërkesë për çështjen e mbeturinave që po hudhen në qendër të qytetit nga shumë qytetarë të pandërgjegjshëm që nuk janë edhe të Komunës tonë, do të kërkoja prej Drejtorisë për shërbime publike dhe Emergjente dhe Drejtorisë së Inspeksionit, që të bëhet një kontroll më i rreptë edhe këtu në Obiliq në qendër edhe te Kampi i Plemetit në Plemetin.

Sami Ahmeti - Në mbledhjen e KPF-së e kam bërë një kërkesë në lidhje me çështjen e përgatitjes për fillimin e vitit shkollor dhe kisha pas dëshirë me pasë ndonjë përgjegje.

Kryesuesja - Nuk kemi askend prezentë nga Drejtoria e Arsimit, edhe pse e kemi dërguar me email kërkesën dhe nëse, përgjegja do të vjen me shkrim patjetër se do t'ua përcjellim.

Mbledhja përfundoi në ora 11:39'

Bashk.prof.për punë të KK

Azize Zeneli

Kryesuesja e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi

